

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6194
E premte, 18 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

Ambasadorja Çitaku
kthehet në Uashington,
ngecën procesi
i emërimeve | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBROJTJA E ISH-KRERËVE TË UÇK-SË KA KËMBËNGULUR
PËR SHTYRJEN E FILLIMIT TË GJYKIMIT NË HAGË | FAQE 4-5

AVOKATËT MBROJTËS: NA DUHEN 18 MUAJ PËR T'U PËRGATITUR



Në konferencën e dytë staturore në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, avokatët mbrojtës kanë thënë se u nevojiten 18 muaj kohë për t'u përgatitur për këtë proces gjyqësor. Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, David Hooper, ka

thënë se më shumë se 18 muaj duhen për të zhvilluar hetime në këtë rast. Sipas tij, afati prej 18-muajsh është minimumi që ata parashikojnë për të filluar që të shikojnë nëse kanë ekipin dhe aspektet e nevojshme për t'u bërë hetimet e nevojshme, e pastaj kjo, sipas tij, do të fillonte në

vitin 2022. Edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka theksuar nevojën që mbrojtja kërkon kohë të mjaftueshme për ta trajtuar çështjen dhe provat e paraqitura nga ana e Prokurorisë. U propozua që konferenca e ardhshme staturore të mbahet në janar

AKTUALE



11 280 RASTE AKTIVE
ME COVID NË KOSOVË | F. 6

PËRURORHET SHËRBIIMI I
BRAHITERAPISË NË ONKOLOGJI | F. 7

KOMUNA E MITROVICËS ZË
VENDIN E PARË PËR MJEDIS
TË PASTËR | F. 10

HOTI I KËRKON KRESHNIK
GASHIT TA LIROJË DETYRËN E
SHEFIT TË AKI-së | F. 3

EKONOMI

THEKSOHET NEVOJA
PËR PROMOVIM DHE NGRITJE
TË NDËRGJEGJES RRETH
ARBITRAZHIT | F. 8

RËNIA E QARKULLIMIT VJETOR
NË KOSOVË, 1.2 MILIARD EURO | F. 9

OSMANI: KOSOVA DHE SHQIPËRIA DUHET T'I QËNDROJNË PRANË NJËRA-TJETRËS | FAQE 3

Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalimin që ka mbajtur të enjten në Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër të vizitës së saj që po zhvillon në Tiranë, ka thënë se

Kosova dhe Shqipëria duhet t'i qëndrojnë pranë njëra-tjetrës në proceset që i presin. "T'i kthejmë dallimet tona në forcë për t'i shtyrë shtetet tona përpara", ka thënë Osmani



OBLIGIMET FINANCIARE TË SERBISË NDAJ KOSOVËS JANË QINDRAMILIARDËSHE | FAQE 7



SPORT

PEJA FITON KLASIKEN NDAJ
PRISHTINËS | F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ambasadorja Çitaku kthehet në Uashington, ngecën procesi i emërimeve

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Vlora Çitaku është kthyer sërish në Uashington në detyrën e saj si ambasadorë e Kosovës në ShBA, pavarësisht se para më shumë se dy muajsh presidenti Hashim Thaçi kishte nënshkruar dekretin për tërheqjen e saj nga ky post. Madje ajo kishte organizuar edhe takime lamtumirëse në Uashington dhe ishte kthyer në Prishtinë, por është detyruar të kthehet sërish në Uashington, pasi partnerët e koalicionit qeveritar nuk kanë vendosur ende se kush do ta zëvendësojë.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës konfirmoi për "REL" se në Uashington është ende në detyrë ambasadorja Çitaku, e cila do ta përfaqësojë Kosovën deri në emërimin e ambasadorit të ri, siç është përcaktuar në dekretin e tërheqjes së saj të nënshkruar nga presidenti.

Bazuar në dekretin e presidentit, ajo mbetet në këtë detyrë derisa të emërohet ambasadori i ri, por në rast se e njëjta nuk mund ta ushtrojë më këtë post, atëherë duhet të emërohet një 'i ngarkuar me punë' (Charge D'Affairs). Sipas të dhënave zyrtare, në Ambasadën e Kosovës në Uashington është vetëm një diplomat.

Pos Uashingtonit, edhe Brukseli, Londra e Tokio kanë



mbetur që shumë kohë me ushtrues detyre pasi Kosova nuk i ka emëruar ende ambasadorët e rinj pas skadimit të mandatit të diplomatëve të kaluar.

Në Ministrinë e Jashtme thonë se "janë në përfundim të konsultimeve për përzgjedhjen e ambasadorëve të rinj" dhe se i gjithë procesi po zhvillohet konform procedurave të parapara ligjore. "Ministrja znj. Meliza Haradinaj-Stublla garanton një proces të drejtë, transparent, në respektim të plotë të procedurave ligjore

dhe kushtetuese. Dhe ajo që është më e rëndësishmja, secili vendim i saj do të merret në konsultim të plotë me kryeministrin e vendit ashtu siç parashohin ligji dhe Kushtetuta", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", këshilltari politik i ministres së Jashtme, Bul Salihu. Sidoqoftë, "REL" ka mësuar nga zyrtarë qeveritarë, se procesi ka ngecur dhe se vështirë që mund të ketë "emërime gjatë këtij viti".

Profesori i Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës, Ibrahim Gashi, vlerëson se

shteti duhet të jetë më serioz për trajtimin sa më dinjitoz të shteteve mike. "Kjo është papërgjegjësia më e madhe e Qeverisë së Kosovës, pavarësisht e cilës qeveri, që vende të tilla si Londra, Brukseli të mbahen me të ngarkuar me punë për një kohë të gjatë", vlerëson Gashi. Ai, madje, thotë se këto veprime po sjellin pasoja, duke iu referuar rastit të Japonisë. "Ne e kemi mbajtur Japoninë, një mike të Kosovës, për më shumë se një vit me të ngarkuar me punë. Pikërisht kjo neglizhencë, apo

nënçmimi ka ndikuar që Japonia të abstenojë në kërkesën e Kosovës për anëtarësim në një organizatë ndërkombëtare. Ky është rezultat i dështimit të qeverisë sonë që të mbajë marrëdhënie të mira", vlerëson profesor Gashi.

Ambasadori i parë i Kosovës në Uashington, Avni Spahiu, thotë se në këtë fazë të ndërrimit të administratës amerikane, do të ishte e nevojshme që ky proces të ishte përmbyllur. "Bëhet fjalë për pozitën kyçe në diplomacinë e Kosovës dhe është nevojë urgjente që ta kemi ambasadorin tonë në Uashington, ku do të kemi një administratë re, pasi ambasadori duhet të vërë kontakt dhe ta fillojë punën me këtë administratë që po vjen, si në aspektin biltateral, por edhe për punën e diplomatit në kuptim më të gjerë", ka thënë Spahiu për "REL". Ai thekson nevojën që ambasadori i ri në ShBA të jetë apolitik. "Të qenët partiak kufizon veprimtarinë e një ambasadori sepse rezervohet gjithmonë më shumë për liderin e partisë së tij së cilës i përket sesa Ministrinë e Jashtme. Kështu që, mendoj se është e rëndësishme që të jetë jopartiak dhe të jetë i përgatitur profesionalisht", ka thënë Spahiu.

BE-ja ndan 6 miliardë euro për Turqinë

BRUKSEL, 17 DHJETOR - Bashkimi Evropian njoftoi të enjten se i ka ndarë Turqisë gjashtë miliardë euro për ta trajtuar problemin me migrantët sirianë. Ankaraja kishte kërkuar nga BE-ja të ndajë fonde për migrantët në mënyrë që t'i mbajë ata në territorin e vet dhe të mos lejojë shkuarjen e tyre në vendet evropiane. Pas krizës më të madhe të refugjatëve që nga Lufta e Dytë Botërore më 2015, kur rreth një milion njerëz arritën në Evropë, Brukseli dhe Ankaraja ranë

dakord më 2016 për të zgjidhur këtë çështje. Sipas marrëveshjes, Turqia u zotua ta pranojë kthimin e migrantëve që mbërrijnë në Greqi dhe të bëjë më shumë për ta ndaluar rrugëtimin e tyre në këmbim të gjashtë miliardë eurove (7,20 miliardë dollarë).

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan disa herë e ka akuzuar BE-në për mospërmbushjen e premtimeve duke thënë se Ankaraja ka shpenzuar 40 miliardë dollarë për më shumë se 3.6 milionë refugjatë sirianë

që jetojnë në Turqi. "Sot shënohet përfundimi i kontraktimit të gjashtë miliardë eurove si mbështetje e BE-së për refugjatët dhe komunitetet pritëse në Turqi", ka thënë Nikolaus Meyer-Landrut, i dërguar i BE-së në Ankara.

Paratë e BE-së janë caktuar për projekte të veçanta sociale brenda Turqisë për t'i ndihmuar refugjatët dhe nuk do t'i paguhet drejtpërdrejt qeverisë turke. Kjo çështje ka qenë edhe arsyeja e ngritjes së tensioneve midis bllokut dhe Turqisë.



Presidenti francez infektohet me Covid

PARIS, 17 DHJETOR - Presidenti francez Emmanuel Macron ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Macron, 42-vjeçar, bëri një test, pasi kishte simptoma të sëmundjes dhe tani do të vetizohet për

shtatë ditë, ka njoftuar presidenca franceze. Presidenti Macron "është ende i ngarkuar" për drejtimin e vendit dhe do të punojë në distancë" ka thënë një zyrtar nga presidenca

franceze. Zonja e parë franceze, Brigitte Macron, është vetizuar, por thuhet se nuk ka simptoma. Franca këtë javë vendosi një orë policore gjatë natës për të ndihmuar në parandalimin e

përhapjes së koronavirusit. Ky vend ka shënuar dy milionë raste të konfirmuara që nga fillimi i pandemisë, me më shumë se 59 400 vdekje, sipas të dhënave nga Universiteti "Johns Hopkins".

Osmani: Kosova e Shqipëria duhet t'i qëndrojnë pranë njëra-tjetrës



Ushtuesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalimin që ka mbajtur të enjten në Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër të vizitës sa saj që po zhvillon në Tiranë, ka thënë se Kosova e Shqipëria duhet t'i qëndrojnë pranë njëra-tjetrës në proceset që i presin. “T'i kthejmë dallimet tona në forcë për t'i shtyrë shtetet tona përpara”, ka thënë Osmani

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TRIANË, 17 DHJETOR - Ushtuesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të vizitës së saj në Shqipëri, ka mbajtur të enjten një fjalim në Kuvendin e Shqipërisë. Në këtë fjalim Osmani ka folur për raportet Kosovë - Shqipëri, për bashkëpunimin për të ardhmen, për dialogun Kosovë - Serbi dhe për ndihmën që duhet ta japë Shqipëria në këtë proces. Ushtuesja e detyrës e presidentit ka theksuar se Shqipëria është jo vetëm atdheu i bashkëvëllezërve e bashkëmotrave tona, por edhe ëndrra jonë e përbashkët. “Ajo është kujtesa jonë historike, vatra në të cilën ne ëndërronim të jetonim, të cilën, fatkeqësisht, shumë prej nesh e takoi së pari vetëm në acarim e ftohtë të luftës. E, megjithatë, ajo u bë vatra jonë, shtëpia e zemërbujarëve shqiptarë, të cilët na mbajtën gjallë ne, por edhe shpresën e përbashkët për liri. Ne ju jemi mirënjohës përjetë!”, ka deklaruar

Osmani.

Ajo ka shtuar se pavarësia e Kosovës e ka vulosur fatin dhe lirinë e popujve në Ballkan. “Ne e kuptojmë se çfarë do të thotë të rritesh nën një regjim shtypës, në të cilin rrënjët etnike janë argumente të mjaftueshme për të qenë i shtypur e i vrarë. Ne e kemi përjetuar këtë dhe mund të dëshmojmë për të. Historinë e kemi në krah. Këtë rrugëtim ne e bëmë bashkë me miqtë tanë të shumtë, të cilëve do t'u jemi mirënjohës përjetësisht. Ata jo vetëm u rreshtuan krah popullit të Kosovës në synimin për liri e pavarësi, por qëndruan krah nesh edhe për ndërtimin e shtetit të Kosovës që nga dita e parë e çlirimit”, ka thënë ajo, duke u bërë thirrje të rinjve të të dyja vendeve që t'i ndjekin synimet e tyre dhe të besojnë se ëndrrat mund të jetësohen. “Të mos dorëzohen para asnjë sfide dhe të këmbëngulin në vlerat e tyre. Një ditë ato do të jenë aty ku duan dhe ku e meritojnë, në majat më të larta të profesioneve të tyre, të

politikës e të bizneseve sepse, sikurse çdo shtet tjetër, edhe Kosova e Shqipëria do të kenë sukses vetëm atëherë kur ta shfrytëzojnë edhe potencialin e 50 për qind të popullatës së tyre që e përbëjnë gratë. Të rinjtë tanë, në Kosovë dhe në Shqipëri, janë kapitali ynë më i çmuar. Ata janë ambasadorët tanë në botë, me të cilët po krenohemi çdo ditë e më shumë. Andaj është obligim ynë që çdo gjë që bëjmë sot, ta bëjmë në mënyrë të tillë që atyre t'u garantojmë një të tashme më të mirë e një të ardhme më premtuese”, ka thënë Osmani. Në këtë fjalim, Osmani ka folur edhe për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Ajo ka pohuar se sot dialogu me Serbinë është ende i pambyllur. “Ne jemi të vendosur që të dialogojmë vetëm për njohjen e ndërsjellë, duke respektuar integritetin territorial dhe sovranitetin e shtetit, duke e njohur dhe pranuar paprekshmërinë e territorit, rregullimin kushtetues dhe nivelin e organizimit politik.

Kosova nuk mund ta shpërblejë Serbinë me territor të saj e as me koncesione të tjera, për politikën gjenocidale që Serbia kishte ndaj nesh. Serbia duhet të pendohet, të kërkojë falje e të dënohet e jo të shpërblehet. Dhe kjo duhet të jetë e qartë për këdo dhe ta themi me zë të lartë këtu e në çdo vend tjetër të botës. Prandaj edhe i kam bërë thirrje këtij Kuvendi të nderuar që t'i bashkohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Rezolutës që dënon gjenocidin serb, sepse vetëm atëherë kur i bashkojmë zërat tanë, ata do të dëgjohen edhe përtej Kosovës e përtej Shqipërisë”, ka deklaruar Osmani. Ajo ka theksuar se askush në trojet shqiptare nuk duhet ta ketë preokupim se si ta shpëtojë fytyrën e Serbisë sepse, sipas saj, fytyra e vërtetë e Serbisë është dëshmuar me politikën gjenocidale që ka ndjekur ndaj nesh. “Por, zonja e zotërinj, motra e vëllezër, që të kumbojë ky zë çdo kund, ne duhet t'i bashkojmë zërat e përpjekjet tona në kërkim

të drejtësisë. Që çdo përfaqësues shqiptar, në Kosovë, në Shqipëri, në Mal të Zi, në Maqedoni e tani edhe zëri kumbues i Shaip Kamberit në Kuvendin e Serbisë, të kërkojë drejtësi për viktimat që i shkaktoi Serbia. Drejtësi për fëmijët e vrarë, drejtësi për motrat tonë që u dhunuan nga serbët si krim lufte, drejtësi për nënat që ende kërkojnë bijtë e bijat e tyre që të kenë një vend ku t'i derdhin lotët e ku të vendosin lule, sepse Kosovës nuk mund t'i kërkojë askush më që të japë më shumë. Kosova ka dhënë më të shtrenjtët e vet. Kosova ka dhënë mbi 1 000 fëmijë, shpirta të njomë, të cilët sot do të mund të ishin këtu ku jemi ne, në këtë sallë ku merren vendimet për të ardhmen e shteteve tona, sikur Serbia mos t'ua këpuste jetën qysh në fillim”, ka thënë Osmani.

Ushtuesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se e kemi detyrë kombëtare, mbi të gjitha detyrë morale, që përderisa punojmë për hapjen e një kapitulli të ri, për gjithë rajonin tonë, fillimisht të lexojmë, të kuptojmë e të mësojmë mirë, kapitullin që akoma qëndron para nesh. “Ky kapitull na mëson se duhet t'i qëndrojmë pranë njëra-tjetrës, si dy motra që nuk kursejnë asgjë për njëra-tjetrën. Ky kapitull, po ashtu, na mëson se Serbia nuk ka ndryshuar dhe ne duhet t'i bashkojmë forcat si Kosovë e Shqipëri, për ta kundërshtuar gjuhën e urrejtjes, gjuhën anti-shqiptare dhe përpjekjet për t'i fshehur krimet. T'i bashkojmë forcat që mos të lejojmë që e vërteta të përmbysset para syve tanë, sepse ekziston vetëm dhe vetëm një e vërtetë, që ka ndodhur para syve të të gjithë botës, e ajo është që Serbia kreu gjenocid në Kosovë, kurse Kosova e mbrojti prapun e shtëpisë së vet”, ka deklaruar ajo.

Ajo ka bërë thirrje që Kosova dhe Shqipëria të punojnë bashkërisht për ta ndihmuar njëra-tjetrën. “Prandaj të punojmë bashkë të gjithë, që si dy shtete sovraane, me dy flamuj e me një shpirt që nuk ka mundur askush ta mposhtë ndonjëherë, të dëshmojmë para botës mbarë, se ne, ilirët e lashtë e evropianët më të rinj, populli më paqedashës, më pro-evropian e më pro-amerikan në botë, mund dhe do t'ia dalë. T'i kthejmë dallimet tona në forcë për t'i shtyrë shtetet tona përpara”, ka thënë Osmani.

Hoti i kërkon Kreshnik Gashit ta lirojë detyrën e shefit të AKI-së

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i ka kërkuar Kreshnik Gashit që ta lirojë detyrën e drejtorit të Agjencisë

Kosovare për Inteligjencë (AKI). Zyra e kryeministrit Hoti nuk ka ofruar më shumë hollësi rreth kësaj kërkesë. Më 25 nëntor të vitit të kaluar,

Gashi ishte emëruar në këtë pozitë nga Ramush Haradinaj, i cili mbante pozitën e kryeministrit të Kosovës. Paraprakisht, Kreshnik Gashi

ka mbajtur pozitën e kryetarit të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP).





MBROJTJA E ISH-KRERËVE TË UÇK-SË KA KËMBËNGULUR PËR SHTYRJEN E FILLIMIT TË GJYKIMIT NË HAGË

AVOKATËT MBROJTËS: NA DUHEN 18 MUAJ PËR T'U PËRGATITUR

Në konferencën e dytë statusore në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, avokatët mbrojtës kanë thënë se u nevojiten 18 muaj kohë për t'u përgatitur për këtë proces gjyqësor. Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, David Hooper, ka thënë se më shumë se 18 muaj duhen për të zhvilluar hetime në këtë rast. Sipas tij, afati prej 18-muajsh është minimumi që ata parashikojnë për të filluar që të shikojnë nëse kanë ekipin dhe aspektet e nevojshme për t'u bërë hetimet e nevojshme, e pastaj kjo, sipas tij, do të fillonte në vitin 2022. Edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka theksuar nevojën që mbrojtja kërkon kohë të mjaftueshme për ta trajtuar çështjen dhe provat e paraqitura nga ana e Prokurorisë. U propozua që konferenca e ardhshme statusore të mbahet në janar

dosjen e saj në gjykatë në qershor ose korrik, me kushtin që gjykimi të nisë në shtator. "Kjo nuk është vetëm qesharake, por edhe absurde. Duhet të ndalet kjo gjykatë e Prokurorisë. Ajo që Tiger sapo tha, është shqetësim mjaft i rëndë. Habitem se si prokuroria i jep këto përgjigje. Është një parashtrim shokues, ka vetëm një arsye, që të kufizojë mundësinë e mbrojtjes për përgatitje, në qoftë se rregullat thonë që për një gjykim mbrojtja duhet të ketë pak kohë për përgatitje është në rregull, por nuk e thotë. Afati përcaktohet nga kompleksiteti i rastit", ka thënë Emmerson.

Ai ka paralajmëruar që bashkëngjitur me kërkesën për lirim të klientit të tij, Veselit, do të dorëzojë edhe prova që dëshmojnë se përgatitjet për mbrojtje në raste të tilla kanë marrë deri në tri vjet e gjysmë. "Është qesharake, është përpjekje e prokurorisë për të pasur një gjykim të padrejtë", shtoi avokati i Veselit.

Emmerson ka thënë se kanë marrë hapat paraprakë për krijimin e një mekanizmi hetimor. Sipas tij, mbrojtja duhet të kryejë hetim më të gjerë për të gjitha akuzat. "Nëse mund ta them për çështjet e tjera gjyqësore, kjo është tepër e

pazakontë. Janë ngritur dyshime kundër të akuzuarve që përpiqet t'i lidhë ata me krime që nuk kanë qenë të përzier", ka thënë ai.

Gjykatësi Nicolas Guillou tha se asnjë vendim nuk do të merret të enjten në lidhje me datën e fillimit të gjyqit, por ai tha se do t'i marrë parasysh të gjitha pozicionet e mësipërme dhe se kjo do të diskutohet në konferencat e ardhshme statusore.

U propozua që konferenca e ardhshme statusore të mbahet në janar.

Konferencën statusore, apo konferencën mbi ecurinë e çështjes e thërret gjykatësi i procedurës paraprake dhe ajo ka për qëllim organizimin e shkëmbimeve midis palëve. Në këtë konferencë prokuroria tregon çfarë lloji të provave ka.

Kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreut të PDK-së, Kadri Veseli, deputetit dhe ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi dhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqi, është konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Të gjithë aktualisht gjenden në paraburgim në Hagë dhe janë deklaruar të pafajshëm. →

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ


PRISHTINË, 17 DHJETOR - Mbrojtja e ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Hagë edhe një herë ka kërkuar që fillimi i gjyqimit kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit të ndodhë brenda 18 muajsh, përkatësisht në verë të vitit 2022. "Më shumë se 18 muaj duhen për të zhvilluar hetime në këtë rast. Ky është realiteti", tha avokati i Hashim Thaçit, David Hooper, në konferencën statusore të mbajtur të enjten në Dhomat e Specializuara në Hagë. Edhe avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se periudha

prej 18-muajsh është e shkurtër. Ai ia ka kujtuar gjykatës se në Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në Hagë, që nga paraqitja e parë e të akuzuarve në gjykatë dhe deri në fillimin e gjyqimit është pritur deri tri vjet e gjysmë. Edhe kjo periudhë, sipas tij, është e gjatë, por theksoi nevojën që mbrojtja kërkon kohë të mjaftueshme për ta trajtuar çështjen dhe provat e paraqitura nga prokuroria. Emmerson mendon se fillimi i gjyqimit në këtë rast ndoshta do të duhej të fillonte në fund të vitit 2022, ose në fillim të vitit 2023, dhe se kjo do të ndikohet nga pandemia dhe vaksinimi kundër Covid-19. Prokuroria ka deklaruar se deri më tani i ka dorëzuar mbrojtjes

mbi 1 300 materiale. Prokuroria, po ashtu, tha se në muajin korrik mund të përfundojnë hetimet dhe në muajin shtator të vitit 2021 të nisë procesi gjyqësor. "Ne do të ishim të përgatitur ta parashtronim dosjen paragjyqësore në fillim të korrikut, pra dy-tre muaj para fillimit të gjyqit", deklaroi prokurori i rastit, Alan Tieger. Avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka kërkuar nga prokuroria të pushojë së paraqituri prova kur të dojë, ndërkohë që e ka quajtur "gjyqin" kërkesën e saj që gjykimi të fillojë në shtator. Emmerson ka kundërshtuar idenë e avokatit të Prokurorisë, Alan Tieger, që ta dorëzojë

Prokuroria nuk jep datë për përfundimin e hetimeve

Prokuroria e Dhomave të Specializuara nuk ka dhënë datë për përfundimin e hetimeve ndaj Hashim Thaçit e të tjerëve. Prokurori ka thënë se është në interes që hetimet të mos ndërpriten për shkak se, sipas tij, mund të paraqiten dëshmitarë të rinj. "Lidhur me pyetjen nëse ka datë për përfundimin e hetimeve dua të theksoj se këto përcaktohen nga procedurat e provave, përdorimi i deklaratave. Kjo siguron që përgatitja e shpejtë të mos ndërpritet. Kjo përputhet edhe me përvojën e tribunaleve që hetimet të vazhdojnë. Kjo ka interes pse hetimet duhet të vazhdojnë duke u nisur nga shtimi i dëshmitarëve që deri tash kanë pasur frikë për dorëzimin e materialeve që kanë qenë të fshehura", ka thënë ai, duke shtuar se nuk janë në gjendje të japin një datë për përfundimin e hetimeve, pasi kjo do të ndikonte në objektivin e tyre. "Për sa i takon vlerësimin se kur do të jenë në gjendje ta parashtojnë dosjen



gjyqësore, në këto rrethana do të ishim të përgatitur ta parashtrojmë dosjen para gjyqësorit në fillim të korrikut", ka thënë ai.

Mbrojtja e të akuzuarve kërkon që dorëzimi i dokumenteve të jetë i organizuar

Avokati i Thaçit, David Hooper, ka

thënë se materialet e prezantuara janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme. Ai ka thënë se janë bërë punë në përgjithësi dhe jo të specifikuar. "Ju jeni në dijeni për formatin e listës që ka shoqëruar materialin që keni dorëzuar. Këto materiale janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme. Janë bërë punë në përgjithësi dhe jo të specifikuar. Kur ceken krimet

duhet të jenë krime kundër njerëzimit apo çfarë krime. Në lidhje me nxjerrjen e materialeve neve na duhet informacion për kategoritë, por edhe për llojin e materialit që na jepet", ka thënë ai.

Avokati i ish-kryetarit të PDK-së, Ben Emmerson, ka thënë se është detyrim i prokurorisë që t'i plotësojë kërkesat e nxjerrjes së materialeve sipas legjislacionit.

"Nuk është praktike që në këtë fazë mbrojtja të bëjë parashtrime me përshtatshmërinë e materialeve", ka thënë ai.

Prokuroria: Mbrojtjes i kemi dorëzuar 1 309 materiale potencialisht shfajësuese

Prokurorja e ZPS-së, Claire Lawson, në konferencën e dytë statusore për çështjen e Hashim Thaçit dhe të tjerëve, ka thënë se prokuroria deri më tani i ka dorëzuar mbrojtjes 1 309 materiale potencialisht shfajësuese. Lawson ka thënë se kanë bërë nxjerrjen e materialeve mbështetëse të aktakuzës. "Materialet e nxjerra përfshijnë 1 764 dokumente duke marrë parasysh problemet teknike që kishim lidhur me nxjerrjen e materialeve dhe ne po kryejmë një kontroll që këto vështirësi të hiqen", ka thënë Lawson. Ajo ka shtuar se presin që paketën e dytë të materialeve potenciale shfajësuese t'ia dorëzojnë mbrojtjes menjëherë pas pushimit të gjykatës.

Hoxhaj: Qeveria dështoi për organizimin e procesit mësimor gjatë pandemisë



EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, i shoqëruar nga deputeti Sejdi Hoxha dhe anëtari i kryesisë, Muzafer Shala, kanë vizituar të enjten Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK). Gjatë kësaj vizite, Hoxhaj ka shprehur shqetësimin e thellë për menaxhimin dhe organizimin e procesit mësimor nga qeveria gjatë pandemisë, e cila ka rrezikuar që të kemi një gjeneratë të humbur.

Ai ka thënë se krahas ruajtjes së shëndetit të nxënësve dhe

mësimdhënësve, Qeveria e Kosovës duhet të merret me cilësinë në arsim dhe, mbi të gjitha, me një plan të qartë kohor se si dëshiron ta menaxhojë procesin arsimor në kohë pandemie. "Ajo që ka ndodhur në gjysmëvjetorin e parë e ka premisën e parë dhe të qartë që mund ta kemi një gjeneratë të humbur në Kosovë për shkak të dështimit të qeverisë që ta ketë një plan të qartë kohor se kur fillon një vit shkollor, kur përfundon një gjysmëvjetor, çfarë masash duhet të ndërmerren që procesi mësimor të jetë i planifikuar mirë", ka thënë Hoxhaj.

Më tutje, Hoxhaj ka thënë se

edhe ndërprerja e mësimin para kohe ishte një vendim jo i drejtë nga qeveria. "Ju e dini që e kanë pasur një plan A, B dhe C dhe tash kanë dalë në opsionin D dhe e kanë ndërprerë mësimin para se të përfundojë procesi mësimor, sikurse është paraparë me kurrikulën e vitit përkatës. Këto shqetësime i ngrehim për këtë arsye", ka thënë kryetari në detyrë i PDK-së.

Hoxhaj i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që tash gjatë një muaji pushim të merret seriozisht që kur të fillojë pjesa e dytë e vitit shkollor ta dijë, që nëse rritet numri i rasteve me të infektuar në Kosovë, atëherë të jenë të përgatitur për mësimin

online. "Këtu duhet të kemi një mendim të plotë se çfarë duhet të ndodhë në sistemin tonë shkollor në kuptimin e digjitalizimit, të pajisjes me kompjuterë të të gjitha shkollave të Kosovës dhe qasjes në internet. Këto tema në vitin 2020 nuk janë më fizikë bërthamore, se të ketë internet dhe pajisje teknologjike kudo dhe të ketë mësimdhënës, të cilët mund ta përdorin teknologjinë për të ofruar përmbajtje arsimore nuk është siç ka qenë para 20 vjetësh", ka thënë Hoxhaj.

Ndërsa kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka falënderuar kryetarin në detyrë të PDK-së, Enver Hoxhaj, për

mbështetjen dhe reformën e tij të vazhdueshme për arsimin në Kosovë, edhe gjatë kohës sa ishte ministër kur ishin dyfishuar pagat për mësimdhënësit, por edhe sot në rolin dhe pozicionin e tij të ri. "E falënderoj kryetarin Hoxhaj për mbështetjen. Ne jemi të interesuar që të ulemi së bashku me të dhe PDK-në dhe të gjejmë mënyra të përbashkëta bashkëpunimi në të mirë të arsimit në Kosovë. Mbështetja e Hoxhajit edhe në kohën sa ka qenë ministër i Arsimit, kur kemi pasur dyfishim të pagave për mësimdhënës, edhe sot, është e mirëseardhur dhe shumë domethënëse për ne", ka thënë Jasharaj.

UNICEF-i dhe Ambasada Britanike furnizojnë 1 020 shkolla me pako higjienike

UNICEF-i dhe Ambasada Britanike kanë lansuar një nismë të përbashkët. Shefi i zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin dhe ambasadori i Ambasadës Britanike në Kosovë, Nicholas Abbott, kanë vizituar Shkollën Filllore "Daut Bogujevci" në Komunën e Fushë-Kosovës dhe kanë shpërndarë 27 pako higjienike për 16 shkolla dhe 30 pako mbrojtëse për mësimdhënësit



në shkurt 2020 nga UNICEF-i, tregon se përqindja e varfërisë të fëmijët është 23 për qind, ndërsa 7 për qind e tyre jetojnë në varfëri ekstreme. Sigurimi i pajisjeve të shkollës

dhe i pajisjeve mbrojtëse nga Covid-19 është një sfidë shtesë për këta fëmijë. Kontributi për shkollat, me mbështetjen e Ambasadës Britanike, përfshin 1 551 pako

higjienike për 1 020 shkolla dhe 1 770 pako mbrojtëse për mësimdhënësit e 29 shkollave në tërë Kosovën, duke përfshirë komunat e banuara nga serbët.

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER)- UNICEF-i në partneritet me Ambasadën Britanike kanë shtuar përpjekjet për t'i përkrahur shkollat me pako higjienike dhe pako për mësimdhënës për ta parandaluar përhapjen e infektiveve në mes të popullsisë së përgjithshme, sidomos në shkolla.

UNICEF-i dhe Ambasada Britanike po reagojnë ndaj nevojave duke shpërndarë më shumë se një mijë pako që përfshijnë maska, sanitarizues të duarve dhe mjete të tjera të nevojshme mbrojtëse për

fëmijët dhe mësimdhënësit. Ndihma ka për qëllim t'i përkrahë edhe familjet sa më shumë që është e mundur për t'u ofruar kushte për mbrojtjen e fëmijëve të tyre përgjatë tërë procesit esencial të arsimimit.

Në Kosovë një nga sfidat më të mëdha për sigurimin e procesit mësimor për të gjithë fëmijët ka vazhduar të mbetet varfëria gjatë periudhës së pandemisë, e cila vazhdon të mbetet dukshëm e lartë në Kosovë. Raporti i analizës së situatës së fëmijëve dhe nënave në Kosovë, i publikuar

11 280 raste aktive me Covid në Kosovë

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 17 dhjetor - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) janë testuar gjithsej 1 470 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 453 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Suharekë dy raste (68, 63 vjeç), Prizren një rast (81 vjeç), Klinë një rast (72 vjeç), Lipjan një rast (78 vjeç), Kamenicë një rast (76 vjeç), Shtime një rast (61 vjeç), Mitrovicë një rast (67 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 47 952 raste nga 168 211 persona të dyshimtë me këtë



virus dhe 1 233 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 483 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 35 439 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 11

280. Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 183 raste, Mitrovicë 37 raste, Fushë-Kosovë 35 raste, Prizren 20 raste, Gjilan 18 raste, Pejë 17 raste, Drenas 16 raste, Ferizaj 15

raste, Vushtrri 13 raste, Podujevë 11 raste, Malishevë 9 raste, Gjakovë 8 raste, Klinë 8 raste, Lipjan 8 raste, Obiliq 8 raste, Suharekë 7 raste, Istog 7 raste, Viti 5 raste, Deçan 4 raste, Skenderaj 4 raste, Graçanicë 3

raste, Kamenicë 3 raste, Kaçanik 3 raste, Dragash 2 raste, Novobërdë 2 raste, Rahovec 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Junik, Shtërpçë dhe Ranillug. Kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije të mërkurën se do të mblidhet së bashku me ekspertë shëndetësorë dhe deri të premtën do të dalin me masa të reja anti-Covid. "Ka tre apo katër ditë që jemi duke diskutuar për masat. Besoj se deri të premtën do ta përfundojmë këtë diskutim. Këto masa jemi duke i diskutuar në bazë të rekomandimeve të ekspertëve dhe organizatave ndërkombëtare. Jemi duke parë se çfarë përvoja kanë vendet e tjera. Nuk mund të them tash se çfarë masa do të marrim për qarkullim dhe për qytetarët nga diaspora, por po them se deri të premtën i finalizojmë konsultimet", ka thënë Hoti në një konferencë për media.

Selmanaj: Nuk ka perspektivë tjetër përpos reformave gjithëpërfshirëse

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Zëvendëskryeministri Driton Selmanaj të enjten ishte i ftuar për diskutimin "ERA 2: A ka perspektivë të re për Kosovën?", i organizuar nga Organizata Joqeveritare "Democracy Plus". Me këtë rast, zëvendëskryeministri Selmanaj potencoi angazhimin me prioritet të lartë të Qeverisë së Kosovës

për përmbushjen e të gjitha obligimeve që burojnë nga ky dokument strategjik, me qëllim të avancimit në rrugën drejt Integritimit Evropian. "Bashkëpunimi gjithëpërfshirës për hartimin e draftplanit të veprimit të prioriteteve dhe krijimi i mekanizmave të përbashkët të monitorimit janë parakushte të nevojshme për ta

promovuar pronësinë e gjithë neve në këtë dokument strategjik për vendin tonë", ka theksuar zëvendëskryeministri Selmanaj. Ai nënvizoi se Qeveria e Republikës së Kosovës e konsideron shumë të rëndësishëm bashkëpunimin e qëndrueshëm me të gjithë hisedarët, posaçërisht organizatat e shoqërisë civile.



Obligimet financiare të Serbisë ndaj Kosovës, qindramiliardëshe

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 DHJETOR- Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka zhvilluar të enjten diskutimin online "Pretendimet financiare dhe pronësore në dialogun Kosovë - Serbi", në të cilin kanë marrë pjesë ekspertë eminentë të fushës si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Gjatë hapjes së diskutimit, Jeta Krasniqi, menaxhere e projektit në KDI, ka theksuar rëndësinë e diskutimit për temat e pretendimeve financiare dhe atyre pronësore, në kohën kur mbi këtë temë është duke u dialoguar në Bruksel. Ajo shtroi për diskutim obligimet financiare, çështjen e borxhit të jashtëm, pensionet, reparacionet e luftës, pretendimet pronësore dhe të tjera.

Ahmet Shala, ish-ministër i Financave, ka thënë se Kosova si shtet ka treguar nivel të lartë të seriozitetit duke marrë përsipër të gjithë pjesën e borxhit të jashtëm të ish-Jugosllavisë, të cilat janë aprovuar nga organet legjitime të Kosovës dhe nga të cilat kanë përfituar qytetarët e saj. Në këtë drejtim ai shtoi se të gjitha borxhet e marra nga Serbia në emër të Kosovës pas vitit 1989 nuk janë obligime të Kosovës, përfshirë edhe periudhën gjatë administrimit të UNMIK-ut, me ç'rast Shala vlerësoi se pikërisht me Rregulloren nr. 1 të UNMIK-ut ishte përcaktuar që nuk mund të merren borxhe në emër të Kosovës nga ana e Serbisë.

Sa u përket obligimeve financiare të Serbisë ndaj Kosovës, sipas Ahmet Shalës, fillimisht duhet të

organizohen tryeza profesionale dhe të përcaktohet metodologjia e qartë e përlogaritjes së dëmeve të luftës.

Sipas përlogaritjeve të tij, në një ndarje prej 25 kategorive ku janë shkaktuar dëme, obligimet e Serbisë janë rreth 250 miliardë dollarë, pa llogaritur dëmet industriale dhe ato ushtarake. "Prej tyre, më pak se 10 për qind e totalit të përgjithshëm të borxheve që Serbia duhet t'ia paguajë Kosovës janë pensionet", ka thënë Shala. Gjithashtu, u trajtua edhe çështja e pronave shoqërore dhe ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës që kanë asete në Serbi, për të cilat u tha se Serbia nuk ka bashkëpunuar, madje ka pasur përpjekje për t'i privatizuar asetet e Kosovës apo t'i pengojë investitorët e jashtëm.

Ai shtoi se Pako e Ahtisaarit e ka adresuar edhe çështjen e pronësisë së ndërmarrjeve publike dhe shoqërore që operojnë në territorin e Kosovës dhe menaxhmenti i tyre është po në Kosovë, duke e konsideruar atë pronë të Kosovës.

Lidhur me pensionet, Artan Mustafa, ligjërues i politikave sociale, vlerësoi që për këtë temë është është krijuar një "mit" pas marrjes së Fondit Pensional të Kosovës nga Serbia në vitin 1992. "Në atë kohë Fondi veçse ka qenë në deficit, duke mos mundur të paguhe obligimet pensionale që kanë ekzistuar", ka thënë Mustafa. Ai vlerësoi që, bazuar në sistemin e atëhershëm 'pay as you go', ku punëtorët aktualë kanë paguar për pensionistët aktualë, i bie se gjenerata e sotme u ka borxh



punëtorëve të asokohe. Ai shtoi që kjo çështje duhet të shqyrtohet me kujdes.

U kërkua, gjithashtu, që në kuadër të dialogut të trajtohet çështja e pensioneve, me qëllim të unifikimit të tërë sistemit pensional të Kosovës, duke e ditur që në Kosovë ka ende dy sisteme paralele që operojnë në këtë fushë. Në këtë drejtim u potencua mungesa e raporteve zyrtare të hartuara nga institucionet e Kosovës për çështjen e pensioneve.

Mungesa e hulumtimeve apo raporteve zyrtare nga institucionet e Kosovës u theksua edhe sa iu përket viktimave dhe dëmshpërblimeve të luftës. Bekim Blakaj, drejtor i Fondit Humanitar për të Drejtat e Njeriut, ka deklaruar që kjo organizatë është në proces të

dokumentimit të të gjithë të vrarëve dhe të zhdukurve në periudhën 1 janar 1998 - 31 dhjetor 2000.

Derimë tani ai tha që janë evidentuar 13 535 persona të vrarë apo të zhdukur gjatë kësaj periudhe në Kosovë, pjesa dërrmuese e të cilëve janë civilë. "Për të njëjtët, por edhe personat e tjerë të burgosur apo të cilët kanë qenë subjekt i trajtimit çnjerëzor, Kosova duhet të përfshijë në marrëveshjen përfundimtare me Serbinë kompensimin e tyre, bazuar në provat e shumta dhe aktgjykimet e institucioneve ndërkombëtare, përfshirë Tribunalin e Hagës për ish-Jugosllavi që kanë dokumentuar përgjegjësinë e krerëve të shtetit serb", është shprehur ai.

Blakaj ka shtuar se është veprim i

duhur që pala e Kosovës ta adresojë çështjen e reparacioneve të viktimave të luftës në tryezën e dialogut duke njohur që dhe familjarët e viktimave joshqiptare ta kenë të drejtën e tyre për dëmshpërblim. "Për të gjitha krimet e kryera në Kosovë, vetëm 65 persona janë dënuar para gjykatave, përfshirë ato në Serbi, Kosovë apo gjykatat ndërkombëtare. Andaj nuk ka drejtësi për viktimat. Kërkimfalja është e rëndësishme si pjesë e reparacioneve", ka deklaruar ai. Të gjithë pjesëmarrësit kërkuan që të ketë bashkëpunim më të madh në mes të institucioneve të Kosovës dhe ekspertëve vendorë, por edhe atyre ndërkombëtarë, në mënyrë që të kontribuohet për përmirësimin e pozicioneve të Kosovës në raport me fazën finale të dialogut me Serbinë.

Përurohet shërbimi i Brahiterapisë në Onkologji

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Në Klinikën e Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është përuar të enjten shërbimi i Brahiterapisë. Metoda e Brahiterapisë shërben për trajtimin e sëmundjeve malinje në kontakt direkt tumor-rreze. Klinika e Onkologjisë do t'i ofrojë këto shërbime nga janari i vitit të ardhshëm, fillimisht vetëm për sëmundjet e organeve gjenitale të femrës.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, aktivizimin e shërbimit të ri për trajtimin e sëmundjeve tumorale e vlerësoi lart, duke thënë se i ka munguar Kosovës shumë. "Ky shërbim i promovuar, i cili është në interes të ruajtjes së shëndetit të qytetarëve, sidomos vajzave/grave, një projekt i munguar, por që mungon edhe në vendet e rajonit, është një



justifikim i mirë për ne dhe qytetarët e Kosovës, për institucionet por, mbi të gjitha, për profesionistët shëndetësorë", ka thënë Zemaj.

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të

ShSKUK-së, dr. Valbon Krasniqi, ka theksuar se ky investim hyn në kuadër të angazhimit për të ofruar shërbime të integruara për pacientët. "Ne kemi filluar edhe projektin për frynim të

asistuar artificial dhe për laboratorët citogjenetikë, që do të kryhet brenda vitit të ardhshëm. Kështu që, në një mënyrë do të rumbullakohet cikli i shërbimeve të integruara

për sëmundjet malinje të femrat", ka thënë Krasniqi.

Drejtori i Klinikës së Onkologjisë, Ilir Kurtishi, tha se pacientët të cilët kanë nevojë për këtë shërbim nuk kanë pse të shkojnë më jashtë vendit. "Numri i rasteve, që kanë nevojë për këtë shërbim, është relativisht i madh. Brenda një viti këtë shërbim e kërkojnë rreth 50 pacientë. Kjo aparaturë mund të shërbejë edhe për trajtimin e tumoreve të organeve të tjera, në raste të veçanta. Gjatë vitit të ardhshëm shërbimet me aparaturën e re do t'i zgjerojmë", ka thënë Kurtishi.

Sipas planifikimeve, brenda tre muajve të parë të vitit 2021 në Klinikën e Onkologjisë pritet të aktivizohet edhe aparatura e re për radioterapi, e cila do të rrezatojë me teknikën IMRT, që do të ofrojë shërbime të një niveli tjetër, shumë më të përsosur se deri tani.

MF-ja jep sqarim për pakot për mbështetje të bizneseve

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 17 dhjetor - Komuna e Prishtinës këtë javë ka bërë publike listën e përfituesve nga pakoja për ndihmë nga kjo komunë, por për këtë pako nuk ka dorëzuar në Thesarin e shtetit për ekzekutimin e saj. Ministria e Financave përmes një komunikatë për media ka njoftuar: "Marrë parasysh se disa komuna të Republikës së Kosovës janë duke ofruar pako mbështetëse për bizneset e goditura nga pandemia, Thesari i shtetit dëshiron të japë disa sqarime dhe udhëzime lidhur me kompetencat, procedurat dhe mënyrën e ekzekutimit të këtyre pagesave në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike në Republikën e Kosovës. Duke marrë shkas nga njoftimi i bërë nga Komuna e Prishtinës rreth pakos së kësaj komune ofruar për bizneset, Thesari njofton se Komuna e Prishtinës ende nuk i ka kryer procedurat e nevojshme për ekzekutimin e kësaj pako, ashtu siç parashihet në rregullativen

ligjore për financat publike, bazuar në informatat nga regjistrat kontabël (SIMFK). Po ashtu, Komuna e Prishtinës nuk ka dorëzuar në Thesarin e shtetit një kërkesë zyrtare për pagesa të tilla (masive) për biznese, meqë kjo gjë s'është e mundur dhe se Thesari pret që nëse ende komuna planifikon ta realizojë ekzekutimin e pakos për biznese, atë duhet ta bëjë sa më parë për shkak të afateve për mbylljen e vitit fiskal dhe përmes sistemit për menaxhimin e financave publike, në pajtim me legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi, që sigurojnë transparencën e duhur dhe llogaridhënie institucionale si organizatë buxhetore, përgjegjëse për dizajnimin dhe zbatimin e saj", është thënë në njoftimin e MF-së, duke shtuar se për këtë proces kjo ministri ka lëshuar një qarkore (datë 09.12.2020) për të gjitha komunat, me udhëzimet e duhura ligjore dhe operacionale. "I kemi kthyer një përgjigje me shkrim Komunës së Prishtinës (më datë 10.12.2020) lidhur me aspektet procedurale të zbatimit të pakos për përfitues



për biznese, bazuar në kërkesën e saj për sqarime rreth këtyre proceseve", thuhet në komunikatën për media. Sipas MF-së, disa komuna veçse janë në përmblyllje të procesit të ekzekutimit të pakove për bizneset lokale, në përputhje me udhëzimet e kësaj ministrie. "Andaj një proces i tillë duhet të ndiqet edhe nga komunat e tjera. Thesari sqaron se, sipas legjislacionit në fuqi, ekzekutimi i buxhetit realizohet nga vetë organizata buxhetore, përkatësisht komuna, përmes sistemit për

menaxhimin e financave publike, në të cilin kanë qasje të autorizuar edhe zyrtarët financiarë të komunave. Thesari qartëson se komunat nuk kanë pengesa që ta realizojnë zbatimin e pakos, ndërsa sipas nevojës do të kenë një afat shtesë për zotimin e mjeteve si dhe për kryerjen e të gjitha proceseve të shpenzimit të buxhetit për realizimin e këtyre subvencioneve. Gjithashtu, komunat do të vazhdojnë të asistohen në baza ditore në pika të caktuara të procesit (hapja e përfituesve në

sistem), duke përfshirë edhe realizimin e pagesave për përfituesit në llogaritë e tyre, sipas procesit të rregullt të ekzekutimit të buxhetit", thuhet në komunikatën e MF-së.

Po në këtë komunikatë theksohet se thesari bën me dije se zbatimi i këtyre pakove është në dorën e autoriteteve komunale (siç kanë bërë disa komuna tashmë) dhe kësaj mbetet në përgjegjësinë e organizatave buxhetore që t'i kryejnë procedurat e rregullta të ekzekutimit të buxhetit, duke mbajtur përgjegjësinë për zbatimin e proceseve të brendshme të kontrollit. "Pretendimet që vonesat në realizim të barten te Thesari janë të pabazuara dhe të pasinqerta. Në fund, Thesari mbetet në dispozicion për të ofruar mbështetje në këtë proces në pajtim me kompetencat ligjore dhe përgjegjësitë, andaj fton komunat që të gjitha çështjet të adresohen përmes komunikimit ndërinstitucional në frymë konstruktive dhe në shërbim të interesit publik", është thënë në komunikatën e MF-së.

Theksohet nevoja për promovim dhe ngritje të ndërgjegjes rreth arbitrazhit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për Drejtësi Komeriale, po organizojnë aktivitetin "Ditët e drejtësisë komerciale: arbitrazhi në fokus" në kuadër të të cilit po organizohen një sërë forumesh virtuale përmes të cilave synohet rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të bizneseve rreth metodave alternative për zgjidhje të kontesteve komerciale. Forumi i parë i kësaj jave trajtoi zhvillimin e arbitrazhit në Kosovë si dhe përfitimet që sjell për bizneset, rrjedhimisht edhe për zhvillimin ekonomik. Christopher Thompson, shef i Programit të USAID-it për Drejtësi Komeriale, ka thënë se ky program, në bashkëpunim me Qendrat e Arbitrazhit në vend, po mbështet përmirësimin dhe zhvillimin e legjislacionit për zgjidhjen e kontesteve komerciale përmes metodave alternative, përkatësisht arbitrazhit dhe ndërmjetësimit, fuqizimi i të cilave luan rol edhe në mjedisin

e investimeve në Kosovë.

Thompson ka pohuar se marrë parasysh ngarkesën e gjykatave, proceset burokratike dhe kohëzgjatjen e zgjidhjes së kontesteve përmes procedurave gjyqësore, arbitrazhi ofron shumë përfitime dhe lehtësira për tejkalimin e këtyre barrierave për të ardhur në një vendim të prerë dhe një marrëveshje mes palëve në afat kohor më të shkurtër. Duke iu referuar procesit të themelimit të Gjykatës Komeriale, Thompsoni ka theksuar se arbitrazhi nuk e pengon gjykatën, por bashkëpunon me të njëjtën dhe lehtëson punën e saj, duke mundësuar shërbim më të gjerë dhe gjithëpërfshirës të komunitetit të bizneseve në vend.

Më tutje, ai ka potencuar se aktualisht ekziston një nivel i ulët i njohurive rreth metodave alternative për zgjidhje të kontesteve, ndërsa ka theksuar edhe nevojën për promovim dhe ngritje të ndërgjegjes rreth arbitrazhit si dhe metodave të tjera efektive, më të shpejta dhe me kosto më të ulët. Për fund, ai, gjithashtu, këshilloi edhe përfshirjen e klauzolës së



arbitrazhit në kontrata mes palëve. Ardi Shita, avokat si dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Qendrës së Arbitrazhit të Odës Ekonomike Amerikane, ka potencuar se në vitet e fundit në Kosovë është shënuar përparim i konsiderueshëm rreth zhvillimit të një sistemi funksional të arbitrazhit dhe metodave të tjera për zgjidhje të kontesteve. Sipas tij, megjithëse kontratat e mëdha me investitorë seriozë në parim përfundojnë në

arbitrazh për shkak të klauzolës së përfshirë në këto kontrata, ende nuk është krijuar një praktikë e mirëfilltë që për kontestet më të vogla komerciale të përdoret kjo metodë. Shita ka theksuar se përmes përpjekjeve të vazhdueshme të qendrave të arbitrazhit, siç është ajo e Odës Ekonomike Amerikane për përfshirjen e kësaj klauzole, është shënuar përparim i madh që reflektohet edhe në zgjidhjen e kontesteve. Shita ka thënë se Gjykata

Komeriale është një ndër iniciativat më të rëndësishme të drejtësisë komerciale në vend dhe duhet të trajtohet me urgjencë si rrjedhojë e paqëndrueshmërisë politike. Ai, po ashtu, theksoi se Kosova njihet dhe ekzekuton të gjitha vendimet e arbitrazhit, përfshirë edhe ato ndërkombëtare. Ngjarjet që do të mbahen gjatë "Ditëve të drejtësisë komerciale" do të përfshijnë diskutime në panel për temat e tjera të lidhura me arbitrazhin sipas industrive specifike.

Rënia e qarkullimit vjetor në Kosovë, 1.2 miliard euro

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të Administratës Tatimore të Kosovës, Ekrem Hysenaj, ka thënë se nga marsi deri në tetor ka pasur rënie të qarkullimit 1.2 miliard euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas tij, nga periudha janar-nëntor ATK-ja ka inkasuar 426.6 milionë euro, 39 milionë euro më pak se periudha e njëjtë e vitit të kaluar

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Pandemia e Covid-19 ka ndikuar në rënie të qarkullimit vjetor në Kosovë. Kështu ka thënë ushtruesi i detyrës i drejtorit të Administratës Tatimore të

Kosovës, Ekrem Hysenaj. Ai ka deklaruar se nga marsi deri në tetor ka pasur rënie të qarkullimit 1.2 miliard euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Hysenaj këto komente i bëri gjatë një vizite të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, në

Administratën Tatimore të Kosovës. Sipas tij, nga periudha janar-nëntor ATK-ja ka inkasuar 426.6 milionë euro, 39 milionë euro më pak se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. "Sektorët që më së shumti janë atakuar gjatë kësaj periudhe i kemi sektorët e argëtimit dhe

rekreacionit, sektori i patundshmërisë dhe sektori i akomodimit dhe shërbimit ushqimor", u shpreh Hysenaj. Kurse kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar nga Administrata Tatimore që ta zbatojë, para së gjithash, Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, por t'i kryejë edhe të gjitha përgatitjet për implementimin e Pakos së Re Fiskale e cila pritet të finalizohet në javët e para të vitit të ardhshëm. "Roli i Administratës Tatimore është kyç për shkak të autorizimeve ligjore që ka në të gjitha

veprimet, por edhe për shkak të përvojës së akumuluar me vite të zyrtarëve ekspertë të cilët janë pjesë e ATK-së", u shpreh Hoti.

Ai nënvizoi se gjatë këtij viti me Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike dhe me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike qeveria është munduar t'i kompensojë maksimalisht bizneset nga ndikimi negativ i pandemisë Covid-19 për aq sa ka qenë dhe është e mundshme. Në këtë vizitë në ATK, kryeministrit Hoti ishte i shoqëruar nga ministrja e Financave, Hykmete Bajrami.



Rrjeti i Shitësve me Pakicë kërkon që të zgjatet orari i punës për festat e fundvitit



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Rrjeti i Shitësve me Pakicë ripërsërit kërkesën ndaj institucioneve vendore për zgjatjen e orarit të punës në të gjitha komunat me qëllim të shmangies së turbimeve të njerëzve për festat e fundvitit dhe për garantimin e mbarëvajtjes së veprimtarive ekonomike gjatë kësaj periudhe të gjendjes emergjente të shëndetit publik. Marrë parasysh situatën në

teren dhe mbylljen e institucioneve të arsimit ditëve në vijim, Rrjeti i Shitësve me Pakicë i bën thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës që të zgjatet orari i lejuar i punës në mënyrë që të ruhet shëndeti publik dhe të garantohet zbatimi i masave. "Është e evidente që kur kufizimi i orarit të punës dhe lëvizjes ka qenë për kohë më të gjatë, konkretisht deri në orën 23:30, numri i të infektuarve në raport


me numrin e testeve ka qenë shumë më i vogël", thuhet në njoftimin e Rrjetit të Shitësve me Pakicë. "Ne rithekojmë se zgjatja e orarit të punës dhe lëvizjes është një nevojë e domosdoshme e komunitetit të biznesit në mënyrë që situata e krijuar mos të ketë implikime më të mëdha jo vetëm në shëndetin publik, por edhe në ekonominë e vendit", thuhet në kërkesën e Rrjetit të Shitësve me Pakicë drejtuar institucioneve.

Kuçi: Serbia po shkel Traktatin e Komunitetit të Energjisë duke bllokuar linjat transmetuese

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit në Qeverinë e Kosovës, Blerim Kuçi, ka thënë të enjten se Serbia po shkel Traktatin e Komunitetit të Energjisë, duke bllokuar linjat transmetuese për Kosovën. Ai i ka bërë këto komente në një takim të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë që këtë

herë është mbajtur në kryesimin e Malit të Zi, pas pavarësisimit energjetik të Kosovës. "Përderisa po flasim për integrim regional të tregut të energjisë, vendit t'm i janë bllokuar nga Serbia, si palë nënshkruese e këtij Traktati, 60 për qind të kapaciteteve transmetuese ndërkufitare. Kjo në parim zhvlerëson edhe vetë

Traktatin", ka deklaruar Kuçi. Sipas tij, këto veprime janë të patolerueshme dhe duhet të sanksionohen nga Bashkimi Evropian. Nga dita e hënë (14 dhjetor), Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) operon si i pavarur dhe kontrollon kufijtë energjetikë të Kosovës.



Lladrovci dhe Likaj marrin pjesë në prezantimin e laboratorit virtual të shkencave të natyrës



DRENAS, 17 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me ministrin e Arsimit, Ramë Likaj, kanë marrë pjesë në prezantimin e laboratorit virtual i cili është lansuar nga Drejtoria e Arsimit dhe do të

jetë në shërbim për të gjitha shkollat e Komunës së Drenasit. Lladrovci ka vlerësuar lart punën e bërë nga nxënësit e shkollave të Drenasit dhe ka inkurajuar të vazhdojnë inovacionet e tjera për krijimin e platformave të tilla të cilat

ndihmojnë nxënësit dhe shkollat në përgjithësi. Ai ka thënë se Komuna e Drenasit me përkushtimin më të madh është duke vazhduar përmirësimin e kushteve në të gjitha shkollat e Drenasit, në përpjekje për t'i përmbushur

standardet e arsimit të konkurrueshëm me ato të Bashkimit Evropian. Lladrovci, po ashtu, ka falënderuar edhe ministrin Likaj për vizitën e bërë dhe ka kërkuar nga ministria që ai udhëheq, që t'i përkrahë

projektet infrastrukturore për shkollat në Komunën e Drenasit.

Edhe ministri Likaj ka përgëzuar nxënësit e Drenasit për krijimin e këtij laboratorit, duke thënë se një projekt i tillë është i standardëve të larta, të njëjta me ato të shkollave evropiane.

Ky projekt është realizuar nga vetë nxënësit e shkollave të Drenasit në përkrahje të Drejtorisë së Arsimit dhe është i pari i llojit të tillë që realizohet në Kosovë, bazuar në planprogramet shkollore dhe do t'u shërbejë si ndihmesë për përvetësimin e njohurive shkencore.

Drejtorja Komunale e Arsimit këtë vit ka pajisur të gjitha shkollat e Komunës së Drenasit me kabinate të shkencave të natyrës dhe të teknologjisë informative dhe ky projekt është në vazhdim dhe plotësimin të standardëve më të larta me mjete konkretizuese.

Hyrja e Ferizajt, së shpejti me katër korsi

FERIZAJ, 17 DHJETOR (ER) - Në pranë të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka nënshkruar projektin për rehabilitimin e rrugës "Hyrja në qytetin e Ferizajt", që është kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ministri Abrashi ka thënë se ky projekt do të ketë impakt në zhvillimin ekonomik të Ferizajt, duke bërë edhe më të lehtë qasjen për qytetarët. "Falënderoj të gjithë ekipin e BERZh-it për bashkëpunimin e treguar. Ky është një projekt i ri që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Ferizajt dhe rruga do t'i ketë katër korsi me të gjitha standardet përcjellëse. Ne sot



nënshkruam kontratën dhe në kohë rekorde do të përfundohen punimet, duke

e kthyer Ferizajn në qytet model në infrastrukturë", ka thënë Abrashi.

Drejtori i BERZh-it në Kosovë, Neil Taylor, ka theksuar se është shumë i lumtur të

shohë që po nënshkruhet kjo kontratë. Ai ka shtuar se projekti ka gjatësi 5.6 kilometra dhe do ta ketë të gjithë infrastrukturën përcjellëse.

Realizimin e projektit e ka fituar kompania italiane "INC", që në emër të saj e nënshkroi kontratën Claudio Dogliani.

Në ceremoninë e nënshkrimit ishte edhe ambasadori i Italisë në Kosovë, Nicola Orlando. Projekti parasheh të përfundojë në janar-shkurt të vitit 2023, që i bie 24 muaj nga dita kur fillojnë punimet. Gjatësia e projektit është 5.6 kilometra me katër korsi dhe do ta ketë ndriçimin, trotualet dhe të gjitha standardet.

Në Gjilan certifikohen 18 edukatore dhe infermiere për alfabetin e gjuhës së shenjave dhe komunikimit verbal

GJILAN, 17 DHJETOR (ER) - Janë certifikuar të enjten në Gjilan 18 edukatore mbështetëse, infermiere e nxënëse të shkollës së mjekësisë "Dr. Asllan Elezi", të cilat e mësuan alfabetin e gjuhës së shenjave dhe komunikimit verbal. Ky trajnim i modulit të parë, i cili ka zgjatuar dy javë, është organizuar nga Qendra Edukative për Fëmijët me Nevoja të Veçanta, me mbështetje të Komunës së Gjilanit. Në ceremoninë e dorëzimit të certifikatave ka marrë pjesë kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili e

ka përgëzuar këtë qendër për realizimin e këtij trajnimi me moton "Ma kupto heshtjen", duke thënë se komuna do të vazhdojë t'i mbështesë në vazhdimësi këto projekte të rëndësishme. Ndërkaq drejtoresha e Qendrës Edukative për Fëmijët me Nevoja të Veçanta, Shpresa Sejdiu, e ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen, duke nderuar atë dhe drejtorin e Arsimit, Nazim Gagica, me mirënjohje për përkrahjen e ofruar për realizimin me sukses të këtij trajnimi.



Narracion përmbysës (2)



Shkruan: Agron HOTI

Nëse Bullgaria e Rumania me shtetësi mbi 100-vjeçare, çuditërisht anëtare të BE-së, edhe sot nuk po mund të bëhen anëtare të Zonës Schengen shkaku i krimit të (pa)organizuar dhe korrupsionit dhe nëse Serbia, e cila përpos që kishte bërë gjenocid në Bosnje e Kosovë, vazhdon tentimdestabilizimin e rajonit, i gurgullon korrupsioni dhe krimi i (pa)organizuar, ka të njëjtët njerëz në pushtet që i kishte në kohën e Millosheviqit dhe gëzon liberalizimin e vizave që 11 vjet si dhe perspektivë të plotë evropiane, për çfarë kriterë na flet Evropa?!

Nëse Ukraina, Gjeorgjia dhe Moldavia kanë pjesë të tyre të pushtuara nga forcat ruse, nuk kontrollojnë tërë territorin e tyre, vlojnë nga korrupsioni dhe krimi i (pa)organizuar, thjesht janë shtete me të ardhme të pashpresë shkaku i Rusisë dhe sot gëzojnë liberalizimin e vizave, krahasuar me Kosovën në zemër të Evropës, kufijtë e së cilës janë po aq të sigurt nga NATO sa edhe vetë kufijtë e BE-së, ka misionin më të madh të BE-së për sundim të ligjit, cila është arsyeja e izolimit të Kosovës si të vetmen në Evropë?! E kundër këtij narracioni negativ askush nuk dëshiron të flasë as në Evropë e as në Kosovë.

Në anën tjetër, harrohet fakti që ka alamet shtete në Evropë që edhe sot vuajnë nga krimi i (pa)organizuar dhe korrupsioni, bile këtë e thonë hapur plot gjyqtarë dhe prokurorë nga shtete të ndryshme evropiane që operojnë në Kosovë, e këtë e thonë edhe mediat dhe

organizata të shumta nëpër këto shtete. Nëse nëpër vende të Evropës parandalimi dhe luftimi i krimit të (pa)organizuar dhe korrupsionit shiheshin dhe shihen si sfida të pafundme të të gjitha shteteve pa përjashtim, në Kosovë ishim ndarë në hajna dhe jo-hajna, mes nuk kishte. Imagjinoni një botë ku narracioni politik do të ndahej vetëm në hajna e jo-hajna. Po të na thuhej që të 27 vendet anëtare të BE-së kanë arritur nivel zero korrupsioni dhe krimi të (pa)organizuar, atëherë çdo narracion ndaj Kosovës, sado përmbysës të kishte qenë, do të kishte plotësisht kuptim, por ama nëse korrupsioni dhe krimi i (pa)organizuar janë përditshmëri në të gjitha vendet e BE-së pa përjashtim, si paska mundësi që kjo dukuri të zhduket në një shtet të mitur siç është Kosova, edhe pse kjo do të ishte ideale, kuptohet?!

Sipas logjikës populiste, nëse në një vend ndodh edhe një aferë e vetme korrupsioni, atëherë i bie që i tërë ai spektër politik të jenë hajna dhe me këtë narracion do të duhej ecur para. Por ama, nëse komunave që drejtojnë popullistët u kanë shpërthyer afera korrupsioni, a do të duhej quajtur të gjithë hajna?! Një fjalë popullore thotë "ç'të mbjellësh do të korrësh", nëse ke sharë e denigruar dikë, me po ato mjete do të sulmohesh. Prandaj, nuk duhet të kërkosh me llupë vetëm të keqen, p. sh., kur një krahu politik në Kosovë i pjellin afera korruptive i tërë ai krahu quhen hajna, e kur krahu tjetër i pjellin të njëjtat afere, i quajnë raste të izoluara e individuale, pra janë këto standarde tipike të dyfishta për të mbajtur të elektrizuar frymën elektorale se ata janë e keqja, kurse ne e mira. Ose kur drejtësia vendos në favor të një krahu politik quhet e kapur, e kur vendos në favor të krahu tjetër s'qenka e kapur. Prandaj, aferat e korrupsionit janë të këqija si për atë apo këtë krahu, me to duhet të merren

institucionet përgjegjëse dhe jo të manipulohet publiku.

Me këtë nuk dua të inkurajoj hajninë, krimin e (pa)organizuar e korrupsionin dhe as edhe një dukuri të vetme negative, përkundrazi, përpos që dua ta mbështes fuqishëm vazhdimin e parandalimit dhe luftimit të të gjitha dukurive negative, dua dhe ta dekurajoj gjuhën fyese, linçuese dhe denigruese që ka polarizuar aq shumë politikën dhe shoqërinë sa që nuk ka vend më as për konsensusin më të vogël. Për këtë arsye forcat e politike në Evropë dhe gjetiu në vende demokratike gjatë veprimtarisë së tyre politike përzgjedhin gjuhën dhe mënyrat e komunikimit politik, e nuk e degradojnë atë duke sharë e linçuar njëri tjetrin, sepse një komunikim politik mes ekstremesh përpos që pastaj polarizon qytetarët, ai për më tepër pengon çfarëdo konsensusi kombëtar, diçka që ka ndodhur 100 % në Kosovë. Është pikërisht degradimi dhe devaluimi i komunikimit politik që sot është bërë pengesë për çfarëdo koalicioni të mundshëm dhe për çfarëdo ecje konsensuale përpara.

E ne zgjodhëm të njëjtën gjuhë ekstreme sikurse popullistët në Evropë, as që donim të dëgjonim atë që thonë të gjitha shtetet e Evropës së paku prej Luftës së Dytë Botërore e deri me sot, se sfida e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit do të zgjasë për aq sa do të ekzistojnë shtetet dhe vetë njerëzimi. Në anën tjetër, forcave politike dhe institucioneve vendore sikur të mos u mjaftonte ky narracion tejet negativ ndaj tyre dhe ato në vend të përpjekjeve për të lëvizur drejt qeverisjes së mirë si kundërpërgjigje ndaj mbjelljes kob e zi, për fat të keq po renditnin skandalet njëri pas tjetrit, secili më i rëndë se tjetri, e kjo veç sa e ushqente narracionin përmbysës për hir të së vërtetës.

Ndërkohë që sot, pra në vitin 2020, sapo filluan arrestimet e Speciales, fare pak ka qarqe nga brenda apo nga jashtë që mbjellin më kob e zi, disi nuk bëzajnë më, thua ti se e zhdukëm tërësisht krimin e (pa)organizuar dhe korrupsionin. E absurdi është se ka nga ata që deri dje nuk kanë lënë gurë pa lëvizur kundër Çlirimtarëve, të cilëve sot, për ta moralizuar veten, kinse u dalin kinse në mbrojtje. A thua pse kjo heshtje apo kinse përkrahje pikërisht tash kur filluan arrestimet e Speciales?! A thua qenka dashur që të gjitha rrugët të çonin njëherë te Specialja e pastaj të fillonte kinse moralizimi?! Apo ndoshta po shkohet nga ajo që Kosova tashmë u godit aq mjaftueshëm nga të gjitha anët, sa tash duhet lënë të merr frymë hëpërhë?! A po mos ndoshta ka interes për përvetësim të lavdisë së Çlirimtarëve për të nxjerrë ca vota më shumë?!

Pa dashur të arsyetoj në asnjë mënyrë të këqij që kanë ndodhur në Kosovë, e pa dashur as të mohoj atë që është arritur me shumë mund e sakrificë e për të cilën as kishte e as ka vullnet të flitet, goditjet e njëpasnjëshme që i janë bërë Kosovës në 5 apo 6 vitet fundit ishin fatale. Harrohet fakti se goditje të tilla rënda nga brenda dhe jashtë do të gjunjëzonin edhe shtete të fuqishme në Evropë se lëre më Kosovën. Se a ishte interes i dikujt shkaktimi i kësaj gjendjeje të rëndë demoralizuese shoqërore dhe politike do ta dëshmojë historia. Ama askush se vë në dyshim faktin se ky demoralizim i përgjithshëm shoqëror dhe politik në Kosovë ishte interes, para së gjithash, i serbo-Rusisë për të sjellë buzë greminës një shtet veç 12-vjeçar. Dhe kjo mbjellje e demoralizimit të përgjithshëm shoqëror dhe politik nuk është që s'ia ka arritur qëllimit, pavarësisht se në interes të kujt mund të ketë qenë dhe sa mund të zgjasë.

E gjatë këtyre 5 apo 6 viteve të fundit qarqe brenda dhe jashtë vendit aq dramatike dhe aq të pashpresë na paraqisnin gjendjen nëpër raporte të ndryshme dhe ballinat mediale sa thua ti në Kosovën e mitur po fluturonin kokat e njerëzve sikur në Meksikë, Brazil, Turqi, Rusi apo Kinë ku korrupsioni dhe krimi i (pa)organizuar gurgullojnë. Ndërkohë që dikush në Evropë pikërisht këtyre shteteve nuk ua lëshon derën me investime e zhvendosje të zinxhirit të prodhimit (shkaku i fuqisë së lirë punëtore). Dikujt as që i bën për superkorrupsionin dhe vrasjet masive në Kinë, me rëndësi tregu i madh kinez, as që i bën për superkorrupsionin dhe krimet e tmerrshme në Brazil, Meksikë, Turqi apo Rusi, me rëndësi tregu i madh në këto vende, të tjerat detaje.

Për çfarë kriteresh demokratike na flitet nga qarqe të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës, kur pesë shtetet e parapërmendura dhe shumë sosh vlojnë nga korrupsioni dhe krimi i të gjitha llojeve të mundshme, ndërkohë që Evropa në vend që të zvogëlojë, përkundrazi rrit investimet e saj në këto zona në glob ku ndiqen, burgosen e vriten për bindje politike pafund gazetarë, gjyqtarë, zyrtarë të ndryshëm, biznesmenë, qytetarë të pafajshëm, diçka që as që mund të paramendohet në Kosovë. Pse heshtet fakti që Kosova në zgjedhjet vitit 2019 dhe të gjitha zgjedhjet e mëparshme kishte dhënë shembullin e zgjedhjeve demokratike dhe ndërrimit të forcave politike në mënyrë demokratike pa trazira e komplete siç jorrallë ndodh në rajon dhe zona të ndryshme autoritare të botës, e me të cilat Evropa për fat të keq bashkëpunon ngushtë së paku në aspektin ekonomik, kurse Kosovën me vetëm 1.7 milion banorë përpos që e mban të izoluar e sheh edhe si treg të papërfillshëm. (Fund)

Komuna e Mitrovicës zë vendin e parë për mjedis të pastër

MITROVICË, 17 DHJETOR (ER) - Komuna e Mitrovicës është radhitur e para në nivel të Kosovës me gjithsej 80 pikë për performancën më të mirë në kuadër të grantit të performancës - mjedisi i pastër. Ky grant është ndarë për komunat të cilat u janë nënshtruar tri kriterëve të qasjes si dhe janë vlerësuar për tre indikatorë të qeverisjes së mirë, të nxjerra nga sistemi i menaxhimit të performancës komunale në

MAPL si dhe tetë indikatorë të menaxhimit të mbeturinave. Komuna e Mitrovicës në raundin e dytë të skemës së grantit të performancës - mjedisi i pastër - pas procesit të vlerësimit të kriterëve dhe indikatorëve të performancës është radhitur në mesin e komunave fituese me vendin e parë duke u shpërblyer me grant në vlerë prej 235.647.00 eurosh.

Me këtë rast, kryetari Agim

Bahtiri ka falënderuar përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe të GIZ-it gjerman që Mitrovicën e kanë radhitur në vendin e parë për nga performanca mjedisore. "Mitrovica me shumë meritë është radhitur e para falë punës dhe performancës së lartë. Ne çdo ditë e me shumë po punojmë për një Mitrovicë të pastër e të ardhme evropiane për të gjithë qytetarët e saj", ka thënë kryetari Bahtiri.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Peja fiton klasiken ndaj Prishtinës

Basketbollisti Dardan Berisha me 38 pikë të shënuara e udhëhoqi Pejën drejt triumfit në kryeqytet kundër Sigal Prishtinës (89:94), ndërsa te vendasit më i dalluari ishte Fisnik Rugova me 28 pikë të shënuara

PRISHTINË, 17 DHJETOR - KB Peja ka shënuar fitore në kryeqytet ndaj Sigal Prishtinës në derbin e rivalëve të vjetër me rezultat 89:94 (19:29, 22:20, 23:27, 25:18) në kuadër të javës së tetë të Prince Caffè Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshja nisi e baraspeshuar, por Prishtina krijoi epërsi 13:7. Nga ky rezultat Peja hyri në një seri prej 17:0, duke kaluar në epërsi 13:24. Çereku i parë u mbyll me epërsinë e mysafirëve 19:29. "Bardhekaltrit" e nisën më mirë periodën e dytë me një seri prej 7:2 për 26:29 dhe më pas ngushtuan shifrat në 41:43, por mysafirët me gjashtë pikë radhazi mbyllën pjesën e parë me epërsi 41:49. "Verdhezinjtë" vazhduan me lojë të mirë edhe në periodën e tretë, duke pasur epërsi deri në 16 pikë, 53:69, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 64:76. Prishtina nuk dorëzohet në 10 minutat e fundit dhe nga 69:84, shkrin epërsinë në vetëm një pikë 83:84. Çastet e fundit ishin dramatike, megjithatë Peja ishte më e vëmendshme dhe fitoi 89:94.

Te Sigal Prishtina u dalluan Fisnik Rugova me 28 pikë e 11 kërcime dhe Edmond Azemi me 25 pikë, kurse te Peja më i miri ishte Dardan Berisha me 38 pikë e pesë kërcime, kurse u ndihmua nga Drilon Hajrizi me 20 pikë e tetë kërcime dhe Marko Peroviq me 21 pikë e pesë kërcime. Sigal Prishtina ka dy fitore dhe gjashtë humbje, kurse Peja shtatë fitore dhe një humbje. Ndërsa në ndeshjen tjetër që u zhvillua të enjten, Bashkimi e mposhti Trepçën në Mitrovicë (91:95).

Takime interesante në xhiron e parë të Kupës

Të premtën dhe të shtunën do të zhvillohen dy ndeshjet në rrethin e parë të Kupës së Kosovës në basketboll në



konkurrencën e femrave. Ndeshja e parë zhvillohet ndërmjet Penzës dhe Kastriotit. Skuadra pejane shihet si favorite ndaj asaj ferizajase. Vashat pejane në stinorin vjeshtor të Superligës së Femrave kishin pesë fitore dhe pesë humbje, kurse vashat ferizajase një fitore dhe nëntë humbje. Takimi tjetër është ndërmjet Kosovahome Prishtinës dhe Trepçës. Edhe në këtë përballje skuadra prishtinase shihet si favorite ndaj asaj mitrovicase. Prishtinaset në dhjetë ndeshjet e Superligës këtë

edicion kishin gjashtë fitore dhe katër humbje, kurse mitrovicaset një fitore dhe nëntë humbje. Fituesi i ndeshjes Penza - Kastrioti në gjysmëfinale do të përballlet me Bashkimin, kurse fituesi i ndeshjes Kosovahome Prishtina-Trepça me Vëllaznimin.

ORARI
Të premtën takohen:
16:00 Penza - Kastrioti
Të shtunën takohen:
14:00 Kosovahome Prishtina-Trepça

Kuka: Distria dhe Lorianana po presin shpërblimet shtetërore

PEJË, 17 DHJETOR - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka thënë se Distria Krasniqi dhe Lorianana Kuka janë sportistet e vetme që kanë fituar medalje këtë vit për Kosovën. Sipas Kukës, sportistet janë në pritje të shpërblimeve shtetërore që iu takojnë ligjërisht. "Distria bashkë me Loriananë janë të vetmet sportiste që sivjet fituan medalje

elitare për Kosovën. U kthyen me medalje nga Evropiani në Pragë. Janë në pritje të shpërblimeve shtetërore që u takojnë ligjërisht, po ashtu së bashku me shumë sportistë e trajnerë në pritje që para vitit të ri t'u kryhen obligimet e kategorizimit sipas rezultateve të arritura gjatë vitit 2019", ka thënë Kuka.



SHKURT

Maliqi largohet nga Llapi

Mbrojtësi Bekim Maliqi e ka confirmuar largimin nga KF Llapi. Maliqi ishte një ndër lojtarët titullar në formacionin e Tahir Batatinas në sezonin vjeshtor. Ai përmes një postimi në "Facebook" bëri me dije se nuk është më pjesë e Llapit dhe ka falënderuar trajnerin dhe klubin për mundësinë e dhënë. "Nga sot nuk do të jem pjesë e KF Llapit. Faleminderit trajnerit Tahir Batatina dhe gjithë stafit për besimin dhe mundësinë e dhënë", ka shkruar Maliqi.

Reali dhe Barça mësojnë kundërshtarët në Superkupën e Spanjës

Real Madridi dhe Barcelona kanë mësuar kundërshtarët e tyre në shortin e Superkupës së Spanjës. Barcelona do të ndeshet me Real Sociedadin, kurse Real Madridi do të ketë punë me Athletic Bilbaon. "Los Blancos" do të zhvillojë duelin me Bilbaon më 13 janar, kurse një ditë më vonë Real Sociedad do ta presë Barcelonën.

Szoboszalai përforcon RB Leipzig

Dominik Szoboszalai edhe zyrtarisht është lojtar i RB Leipzigut. Këtë lajm e ka confirmuar vetë klubi i Bundesligës gjermane, i cili ka thënë se sulmuesi anësor hungarez ka firmosur një kontratë pesëvjeçare. Szoboszalai do të mbajë veshur fanellën me numër 17. Te klubi i Leipzigut hungarez do të transferohet për një shifër prej 20 milionë eurosh dhe ish-klubi i tij Salzburgu do të rezervojë 20 % të rishitjes së tij.

Muriçi nuk i ka përmbushur pritshmëritë te Girona

"Gardiani" i Përfaqësueses së Kosovës, Arijanet Muriçi, në verën e këtij viti u huazua nga Manchester City te skuadra spanjolle Girona, e cila garon në Ligën e Dytë të Spanjës. Shqiptari 22-vjeçar nga Mali i Zi nuk po arrin që të përshtatet në klubin e ri derisa është paraqitur vetëm në dy ndeshje zyrtare në këtë edicion. Te Girona, që është në pronësi të pronarëve të Cityt, krahas Muriçit janë huazuar edhe Yan Couto dhe sulmuesit Nahuel Bustos dhe Pablo Moreno. Gazeta spanjolle "Sport.Witness" shkruan se lojtarët në fjalë nuk i kanë arritur pritshmëritë. Vetëm Moreno ka arritur që të zë vend në përbërjen e parë, por jo edhe të tjerët. Muriçi nuk e gjeti veten as në edicionin e kaluar te Nottingham Forest në Ligën e Dytë angleze ku regjistroi vetëm katër paraqitje.

Caravello: Muriqi nuk është lojtar i duhur për Lazio, por për Fiorentinën

ROMË, 17 DHJETOR - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, në verë u transferua te Lazio, por deri më tani ai nuk ka arritur të shënojë asnjë gol dhe nuk ka treguar atë që e tregonte në skuadrën e Fenerbahçes. Vazhdimisht ka pasur kritika në lidhje me

blerjen e tij, teksa së fundmi ai që flet në lidhje me këtë transferim është agjenti i njohur Danilo Caravello. Ky i fundit ka thënë se Muriqi nuk është sulmuesi që i duhet Lazios dhe vendi i duhur për të do të ishte Fiorentina. "Nuk kemi pasur mundësi ta shohim

shumë, por nuk mendoj se është sulmues për lojën e Lazios. Jo se nuk është i mirë, por ndoshta ishte nevoja për një sulmues me cilësi më të ndryshme, duke pasur parasysh lojën e Lazios. Muriqi është lojtar që pret topin në zonë nga krosset, por kjo nuk

është ajo që bën Lazio. Muriqi mund të jetë ideal për Fiorentinën. Ai është ajo që u mungon violave për ta finalizuar punën e Castrovillit dhe Riberys. Ai është qendërsulmues, ndërsa Lazio ka nevojë për diçka tjetër", ka deklaruar Caravello.



Kabashi: AEK-u është favorit, por do ta japim maksimumin

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Klubi i Hendbollit Prishtina në fundjavë i luan ndeshjet e para evropiane për këtë edicion. Në kuadër të raundit të tretë të Kupës Evropiane, Prishtina takohet me skuadrën e njohur greke, AEK. Të dy ndeshjet luhet në Athinë. Ndeshja e parë zhvillohet të shtunën nga ora 18:00, kurse të dielën luhet ndeshja e dytë në termin të njëjtë. "AEK-u është ekip

shumë i fortë. Ka në përbërje katër lojtarë të Spanjës, një kroat, një serb, një austriak, një brazilian dhe shumë lojtarë kualitativë vendorë. Ekipi ynë është me 100 për qind vendorë. AEK-u është favorit, por do ta japim maksimumin", ka thënë trajneri i Prishtinës, Taib Kabashi. Prishtina ka angazhuar disa lojtarë nga skuadrat e tjera, që në Greqi të paraqitet sa më mirë. Në

raundin e dytë të Kupës Evropiane, Prishtina e eliminoi pa lojë Dobrudjan bullgare. Skuadra bullgare hoqi dorë nga ndeshjet. Shorti i raundit të tretë nuk e ka favorizuar Prishtinën. "Kemi disa përforsime dhe disa mungesa. Kemi angazhuar Arbër Currin e Vëllaznimit si dhe Festim Mustafën e Arben Dugollin të Kastriotit", ka theksuar Kabashi.



Kompletohen 16 skuadrat finaliste të Kupës



REZULTATET

Prizreni - Feronikeli	0-4
Drita - Trepça	2-1
Ramiz Sadiku - Arbëria	1-2
Vëllaznimiti - Trepça '89	1-3
Vushtrria - Drenica	0-1
Besa - Istogu	0-2
A&N - Kika	5-1
Dardana - Ballkani	0-1
Kosova VR - Prishtina	2-6
Onix - Llapi	2-4
Flamurtari - Drenasi	1-1,
	2-1 pas vazhdimëve
Vitia - Ferizaj	2-3
Ulpiana - Liria	2-0
Vilaznia - Dukagjini	1-4
Malisheva - 2 Korriku	1-1
	2-3 pas vazhdimëve

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Janë kompletuar 16 skuadrat që do të marrin pjesë në fazën e ardhshme të Kupës së Kosovës në futboll. Të enjten janë zhvilluar pesë ndeshjet e fundit të fazës së

1/16 së finales, por befasi nuk pati dhe në të gjitha ndeshjet kualifikimin tutje e kanë siguruar skuadrat e Superligës, ani pse rivaliteti nuk mungoi. Kampionia në fuqi e Kosovës, Drita, me

mund të madh e ka eliminuar Trepçën, pasi e ka mposhtur 2-1. Feronikeli e kishte me të lehtë ndaj Prizrenit (0-4), kurse tutje janë kualifikuar edhe Arbëria, Drenica dhe Trepça '89.

SHKURT

'France Football': Collina është gjyqtari më i mirë i të gjitha kohëve

Pierluigi Collina është zgjedhur gjyqtari më i mirë i të gjitha kohëve nga "France Football". "Ai e ka shkruar historinë e futbollit. Kur është çështja te gjyqtarët, emri i parë që të bie ndër mend është i tij. Që nga debutimi i tij në vitin 1977, e deri te lamtumira e tij në vitin 2005, Collina e ka shkruar historinë e futbollit", shkruan "France Football". Collina ka ndarë drejtësinë në 240 ndeshje në Serinë A gjatë karrierës së tij. Ai ishte gjyqtar kryesor edhe në finalen e Kupës së Botës në vitin 2002 midis Gjermanisë dhe Brazilit. Gjithashtu, është shpallur gjyqtari më i mirë në botë nga Federata Ndërkombëtare e Futbollit për Histori dhe Statistika nga viti 1998 deri më 2005.

Mourinho: Kloppi po e tepron, mua më përjashtojnë për sjellje të tilla

Trajneri i Tottenham Hotspurit, Jose Mourinho, është ankuar për sjelljet e trajnerit Jurgen Klopp gjashtë ndeshjes derbi Liverpool - Tottenham. Portugezi është i bindur se do të ishte përjashtuar nëse do të vepronte sikurse trajneri gjerman. "Nëse unë do të kisha bërë sjellje të njëjtë si ai nuk do të kisha shanse të qëndroja aty. Do të më kishin përjashtuar pas një minute. Gjyqtarët e lejojnë atë të sillet siç t'i dojë qejfi. Nuk është problemi im. Ndihem i trishtuar për këtë sepse unë nuk mund të sillem siç dua", ka deklaruar Mourinho.

Conte: Fitorja ndaj Napolit vlen dyfish

Trajneri i Interit, Antonio Conte, është shprehur i kënaqur me suksesin që arriti skuadra e tij ndaj Napolit (1-0). "Nuk ishte aspak një ndeshje e lehtë. Napoli është një ekip i shkëlqyer. Ishte një përballje shumë taktike. Të dy ekipet e respektuan njëri-tjetrin. Sigurisht që nuk ishte një ndeshje e bukur për t'u parë, por rëndësi kanë tre pikët që morëm. Fitorja ndaj një skuadre ambicioze si Napoli vlen dyfish. Djemtë e ndien peshën e fitores në minutat e fundit. Interi duhet të mësohet të vuajë dhe t'i përjetojë këto lloj situatash, por është një sinjal i mirë të fitosh në këtë mënyrë", ka thënë Conte.

Neuer: Po pranojmë shumë gola, duhet të përmirësohemi

Kapiteni i Bayern Munchenit, Manuel Neuer, ka thënë se skuadra është duke pësuar shumë gola. "E kemi mbyllur ndeshjen shumë pak herë pa pësuar gol dhe kjo ka filluar të më shqetësojë. Është detyra ime t'i ndaloj golat. Kemi pësuar nga disa gabime të vogla që në fund kanë rezultuar të mëdha, por goli i Wolfsburgut ishte shumë i bukur dhe nuk kisha asnjë mundësi për të reaguar. Gjithsesi, në fund rëndësi kanë pikët dhe ato shkuan në favorin tonë. Është e vërtetë që skuadra nuk po shkëlqen, por kjo nuk është shqetësuese. Mendoj se loja do të vijë në ngritje", ka thënë Neuer, i cili është i bindur se Bayerni di se si të mposhtet Bayer Leverkuseni.

Cavani akuzohet për sjellje raciste

Edinson Cavani është akuzuar zyrtarisht nga FA (Federata Angleze) për sjellje raciste për një term të përdorur në profilin e tij në "Instagram". Uruguaiani, tashmë lojtar i Manchester Unitedit, shkroi "gracias negro!", në përgjigjen që i dha një fansi në një histori në "Instagram", pastaj e fshiu shpejt komentin. Federata javët e fundit ka kryer hetimet e veta mbi rastin dhe më pas ngriti zyrtarisht akuzën. Cavani tani do të ketë kohë deri në 4 janar për ta paraqitur mbrojtjen e tij para organeve të Federatës. Lojtari, i mbështetur nga klubi i tij, siguroi se ishte një term dashamirës dhe se në Amerikën e Jugut nuk ka një kuptim negativ. "Jam plotësisht kundër racizmit dhe e fshiva postimin shumë shpejt, sapo m'u shpjegua se mund të interpretohet ndryshe. Unë sinjerisht kërkoj falje për këtë", ka thënë Cavani.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një veper filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Trim Jakup Reka shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë me nr. 564.
- ▶ Drilon Qafleshi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - V shf " Emin Duraku " Prizren.
- ▶ Drilon Qafleshi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX shf " Leke Dugagjini " Prizren.
- ▶ Driton Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesat shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

